



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI I KONKURENCËS

VENDIM

Nr. 544, Datë 20.09.2018

“Për një ndryshim në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 526 datë 14.06.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraparak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Znj. Juliana LATIFI	Kryetar
Z. Eduard YPI	Zv/Kryetar
Znj. Leida MATJA	Anëtar
Znj. Adriana BERBERI	Anëtar
Z. Helidon BUSHATI	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.09.2018, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Për një ndryshim në vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 526, datë 14.06.2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraparak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar (Ligji Nr. 9121/2003).

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm mbi procedurën e hetimit paraparak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë,

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës me Vendimin Nr. 526, datë 14.06.2018 2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraparak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”, ka vendosur hapjen e procedurës së hetimit paraparak në tregun e ndërmjetësimit të bankave për periudhën kohore nga 01 Janari 2016 deri në 31 Maj 2018. Raporti i hetimit paraparak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se 3 (tre) muaj nga dita e çeljes se këtij vendimi.
2. Gjatë procedurës së hetimit paraparak janë kryer inspektime pranë bankave objekt

hetimi dhe është kërkuar informacion prej tyre në mënyrë shkresore.

3. Koha e mbetur në dispozicion, nga momenti i depozitimit të informacionit të kërkuar, është e pamjaftueshme për përpunimin, vlerësimin dhe kryerjen e analizës së sjelljes së ndërmarrjeve që operojnë në tregun objekt hetimi, duke bërë të pamundur përfundimin e procedurave dhe dorëzimin e raportit brenda afatit.
4. Komisioni i Konkurrencës çmon se realizimi i plotë i procedurave të hetimit paraprak me qëllim analizimin e sjelljes së ndërmarrjeve në treg, është i domosdoshëm për të siguruar një vendimmarrje objektive.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, shkronja (d) dhe nenin 26 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar,

VENDOSI:

1. Në Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 526, datë 14.06.2018 2018 “Për hapjen e procedurës së Hetimit Paraprak në tregun e ndërmjetësimit në sigurime nga bankat e nivelit të dytë”, të ndryshohet si vijon:

“3. Raporti i hetimit paraprak duhet të paraqitet në Komisionin e Konkurrencës jo më vonë se data 22 nëntor 2018.”

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi dhe njoftimin e palëve të interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS